**VENDIM**
**Nr.1241, datë 10.9.2008**

# PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR.1046, DATË 16.7.2008 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE "PËR KALIMIN NË PËRGJEGJËSI ADMINISTRIMI NGA TIPOGRAFIA USHTARAKE SH.A., SHTYPSHKRONJËS SË LETRAVE ME VLERË, TIRANË, TË DISA REPARTEVE DHE TË NJË TRUALLI FUNKSIONAL "

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 13, 14, e 15, shkronja « c » të ligjit nr.8743, datë 22.2.2001 "Për pronat e paluajtshme të shtetit", të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Brendshëm dhe të Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1.Pika 1, e vendimit nr.1046, datë 16.7.2008 të Këshillit të Ministrave, ndryshohet si më poshtë vijon:

«1. Kalimin në përgjegjësi administrimi nga Tipografia Ushtarake, sh.a., Shtypshkronjës së Letrave me Vlerë, Tiranë, të disa reparteve, me sipërfaqe 1 625 (një mijë e gjashtëqind e njëzet e pesë) $m^2$ , sipas planvendosjes, që i bashkëlidhet këtij vendimi. ».

2.Ngarkohen Ministri i Brendshëm, Ministri i Financave dhe zyra e regjistrimit të pasurive të paluajtshme, Tiranë, të ndjekin procedurat e nevojshme për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
**Sali Berisha**

# PLANIMETRIA E SH. A TIPOGRAFIA USHTARAKE

SHK. 1:100



PLANIMETRIA E SHA TIPOGRAFIA USHTARAKE, PORCELAN

